

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Korça Half Marathon "Little Paris"/ Mbi 1100 vrapues në edicionin e parë ndërkombëtar
ADRESA	https://www.cna.al/qyteti-im/korca-half-marathon-little-paris-mbi-1100-vrapues-ne-edicionin-e-pare--i474705
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 13:57:04 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 13:42:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b3e9d58458b2b8e61ffa2546250fc39284bf9d2fa6cac58db61a33365e4c0900
TEKSTI	311eb596831099e81d9d1347470f30a08bcf13e2751e675bb1baf65cc111a394
PAMJA	24b2a49d82b8ac96e0ccaa2c687e12daca1545ec1f8cceb84e73a28bab39e01f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d7525ff1da1f3da959c43e08b901c8bd138acd7f3ca48ae915d2c0e49e22381f
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9767af9aea99dbf2ca0400fc3d10892444ae0e1100c3c88a0d864d11255bea91
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d7525ff1da1f3da959c43e08b901c8bd138acd7f3ca48ae915d2c0e49e22381f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)




English
English

Korça Half Marathon “Little Paris”/ Mbi 1100 vrapues në edicionin e parë ndërkombëtar



20 Shtator 2026, 15:42, Qyteti im CNA



Korça është kthyer në kryeqytetin e vrapimit, me edicionin e parë ndërkombëtar të gjysmëmaratonës “Little Paris”. Mbi 1100 vrapues, nga Shqipëria dhe vende të ndryshme të botës, u bënë pjesë e garës që përshkoi rrugët e qytetit juglindor.

Me tri distanca të certifikuar, 5, 10 dhe 21 kilometra, si dhe aktivitete për grupmosha të ndryshme, organizatorët synojnë që kjo garë të kthehet në një traditë të përvitshme për Korçën. Mes pjesëmarrësve, spikatën edhe sportistët fitues, ndërsa vëmendjen e mori vrapuesi 81-vjeçar, Sotir Qiriaqi, i cili lu bashkua garës për të nderuar qytetin. Organizatorët e konsiderojnë këtë edicion si pikënisjen e një tradite të re sportive për Korçën.

“Atëherë, ky është edicioni i parë internacional, Korça Half Marathon ‘Little Paris’”. Është maratona e cila është regjistruar në kalendarin botëror të maratonave, është e certifikuar në distancat 5 kilometra, 10 kilometra dhe 21 kilometra. Është edicioni i parë dhe do të jetë një traditë në qytetin e Korçës. Kjo është maratonë e vendosur shumë mirë në rrugët më të bukura të këtij qyteti. Në këtë qytet vërtet brilant. Në këtë edicion të parë ishte një pjesëmarrje e paparashikuar, tej parashikimeve tona. Siç e shikoni, kemi 1,100 vrapues e më shumë, të cilët marrin pjesë në të tëra disiplinat. Kemi një pjesëmarrje të jashtëzakonshme. Ka qenë një ditë brilante, një ditë shumë e bukur për qytetin e Korçës. E gjithë Korça feston sot”, shprehet Dashamir Çali, kryetar i shoqatës.

Pjesëmarrja e lartë dhe interesi i sportistëve e kanë kthyer këtë edicion të parë në një surprizë edhe për vetë organizatorët. Përveç garave kryesore, aktiviteti përfshiu edhe një vrapim prej 3 kilometrash, ku u angazhuan nxënës të shkollave të mesme të qytetit, si dhe distancën 5 kilometra në kategorinë “Fun Run”. Në garën prej 21 kilometrash morën pjesë sportistë të moshës 18 vjeç e sipër, ndërsa në start u shënuan edhe mbi 45 pjesëmarrës të huaj.

“Edicioni i parë Korça Little Paris. Një surprizë shumë e bukur edhe për ne vetë organizatorët, nuk e prisnim një entuziazëm dhe një pjesëmarrje të tillë. Konfirmojmë që ishin mbi 1,100 vrapues, kryesisht nga qyteti i Korçës, por siç e tha dhe kryetari kjo është një maratonë internacionale. Kishim mbi 45 të huaj pjesëmarrës që në edicionin e parë. Realisht ndihemi krenarë. Atëherë, kishim një vrapim 3 kilometra ku përfshiheshin të gjitha moshat e shkollave të mesme të qytetit të Korçës. Gjithashtu edhe 5 kilometra kjo ishte në Fun Run. Kemi edhe disiplinën e 21 kilometrave që këtu bëjnë pjesë nga 18 vjeç e sipër. Vlen të theksohet që kishim një nga personazhet më karizmatikë të maratonave shqiptare, djaloshi rebel zotin Sotir Qiriaqi, 81 vjeç. Që ishte edhe vrapuesi më i madh në moshë në edicionin e parë zyrtar të Korça Little Paris”, tha Leonard Peço.

Mes garuesve që u ngjiten në podium ishte edhe Lis Binaku nga Gjakova e Kosovës, i cili fitoi distancën 5 kilometra. Për të, pjesëmarrja në Korçë ishte një eksperiencë e veçantë, ndërsa fitorja erdhi pas një periudhe me përgatitje të kufizuara dhe një dëmtimi të lehtë.

“Për mua është hera e parë që vij në Korçë. Ishte eksperiencë e jashtëzakonshme. Korça është qytet i bukur, i pastër. Është hera e parë që vij vetëm të marrë pjesë për garën prej qytetit të Gjakovës, Kosovë. Faleminderit shumë për organizimin, gara ishte me konkurrentë të fortë. Është hera e dytë që zë vendin e parë. Kam afërsisht 1 vit, nuk kam shumë që vrapoj. Po mundem me e rritë shumë shpejt performancën time, me ndihmën e trajnerit tim Dren Bardhi, të cilin e falenderoj shumë, edhe gjithashtu me ndihmën e Zotit se pa të nuk bëhet asgjë. E kam patur një lëndim të vogël, kam pushuar 2-3 javë afërsisht. Kam marrë pjesë në garën e Gjakovës javën e kaluar edhe pa pasur shumë përgatitje kam marrë pjesë edhe këtu. Me rezultatin nuk është se jam shumë i kënaqur, por përderisa dola i pari, jam shumë me fat”, tha Binaku.


Në distancën kryesore, atë prej 21 kilometrash, fitues u shpall Ilir Këllezi, i cili e përjetoi këtë rezultat me emocione të veçanta, pasi gara u zhvillua në qytetin e tij të lindjes. Me këtë fitore, ai numëron 75 kupa dhe mbi 203 medalje gjatë karrierës së tij sportive.

“Kjo është hera e 12-të që ari në Shqipëri në maratona i pari. Emocionet janë shumë të mëdha, siç është kur zhvillohet në qytetin të tyre. Kjo garë duhet të bëhet dhe përpara, por jam shumë i lumtur që zhvillohet edicioni i parë dhe aq më shumë që fitoj vendin e parë në edicionin e parë të gjysmëmaratonës. Në fakt kam ikur që në fillim i pari dhe e kam mbajtur pothuajse të njëjtin ritëm me rritje graduale. Kam pasur një kundërshtar shumë të fortë që ka qenë nga Turqia, gjithashtu dhe një grek. Me fitoren e sotme m'u bënë 75 kupa dhe mbi 203 medalje”, u shpreh Këllezi.

Një nga momentet më të veçanta të këtij edicioni ishte pjesëmarrja e Sotir Qiriaqit, 81-vjeçarit që u bë vrapuesi më i moshuar i garës. Me një eksperiencë prej dekadash dhe mbi 390 gara të zhvilluara në vende të ndryshme të botës, ai u bashkua aktivitetit për të nderuar Korçën, pavarësisht se, siç tregon vetë, nuk kishte qenë në gjendjen e tij të zakonshme fizike. Për të, gjysmëmaratona është një dhuratë për qytetin, por edhe një aktivitet që duhet ruajtur dhe zhvilluar më tej.

“Unë ju falenderoj së pari që po më merrni intervistë, jam shumë i kënaqur. Kjo mund të jetë intervista e 29 viteve, nga Çikago, Nju Jorku, Amsterdami, Melburni, Torino, Milano, Firenze, Korça sot! Kam vrapuar mbi 390 gara dhe Korça sot ishte fantastike, mos harrojmë t'ju them që Korça nuk është qytet spontan, Korça është qyteti i Motrave Qirjazi, i Liceut të Korçës, i sportistëve të mëdhenj, i Skënderbeut të Korçës, i djemve dhe vajzave shumë të mira. Dhe Korça sot në kurorën e argjendit me të gjitha aktivitetet që bën, vuri dhe një margaritar të vogël që është Maratona e Korçës. Sot me thënë të drejtën unë erdha për ta respektuar Korçën se s'kam pasur kondicione fizike të rregullta, por vrapova, eca 5 orë, u takova dhe me ato vajzat që takova rrugës dhe jam shumë i kënaqur që bëra një garë. Se maratona ka disa gjëra: maratona do të ketë siguri, do të ketë vijëzime, do të ketë rregulla. Këta janë çunat e talentuar, Nardi dhe Dashi janë shokët e mi të 'Maraton Albania' se unë jam një nga krijuesit e kësaj gare. Por unë kam pozicionin tim si vrapues, si këshilltar dhe uroj që Korça ka marrë një dhuratë të madhe, këtë duhet ta mbani, ta çoni deri në fund sepse vendi është vendi i Pavlina Evros, i Kasapit dhe i shumë atletëve të tjerë të mëdhenj”, tha Qiriaqi.

Edicioni i parë i Korça Half Marathon “Little Paris” solli në qytetin juglindor një festë të sportit, duke bashkuar vrapues të moshave dhe përvojave të ndryshme. Nga nxënësit e shkollave të mesme të atletët me përvojë ndërkombëtare, aktiviteti synon të kthehet në një pikë takimi për sportistët dhe një traditë të re për Korçën. Me mbi 1100 pjesëmarrës dhe interesin e rregullt që në edicionin e parë, organizatorët shpresojnë që kjo garë të vijojë të rritet në vitet e ardhshme, duke e vendosur Korçën gjithnjë e më shumë në hartën e aktiviteteve ndërkombëtare të vrapimit. /CNA





Të sugjeruara

Nis nata e tretë e “Serenights”/ Korça nën tingujt e serenatave

Nata e dytë e "Serenights Festival"/ Korça këndon në ritmet e serenatës

"SERENIGHTS FESTIVAL", NATA E DYTË E SERENATAVE NË KORÇË

"Serenights Festival"/ Korça nis nesër 4 netët e serenatave

"Korça serenights festival"/ Qyteti nën ritmet e serenatës, ja cilët artistë do të performojnë për 4 net radhazi

Në qytetin e poetëve

"SERENIGHTS FESTIVAL" rikthehet në Korçë/ 4 net, 4 vende dhe një dashuri për serenatën

Kur pëllumbat bëhen jetë/ 28 vite pasion në Pogradec

KoKo Fest mbyll edicionin e 13-të/ "Babai" shpallet shfaqja më e mirë

Nisin regjistrimet në Universitetin e Korçës/ Rritet interesi për ekonominë dhe informatikën

"Dola për një shëtitje"/ Arti bashkon 11 artistë në Korçë

"Korça Serenights", zbulohen risitë e edicionit të tretë/ 4 net serenata, nga rrugicat e qytetit te Pazari i Vjetër

Korani, simbol i liqenit të Pogradecit/ Hidhen 2 milionë rasate, rëndësi edhe për gastrinomën

Festa e Bukës së Re në Drithas/ Tradita 20-vjeçare që bashkon fermerët dhe emigrantët

"Çmenduria" që u bë realitet në detin Jon/ Si u shndërrua toni blu i Gjergj Lucës në thesarin e eksportit shqiptar

Akuzat për "vjedhje" dyersh te biblioteka e re "Thoma Turtulli"/ Projekti sot flet vetë

Festa e Mokrës, edicioni i 7-të/ Mokrarët bashkohen për traditën, këngën dhe gatimet

Pamje të Maliqit gjatë viteve të luftës/ Ekspozita me fotografi historike e hapur deri të dielën

Festa e Lakrorit në Polenë/ Tradita dhe shija e juglindjes


Ekspozita me fotografi historike/ Arkivi i arkeologut grek sjell pamje të Maliqit gjatë viteve të luftës

[editorial](#)

15:14 Editorial

Katër burra që hynë në histori dhe një kryetar bashkie që nuk di të dalë nga karrigia

CNA LIVESTREAM



Na ndiqni edhe në



[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH

[opinion](#)

11:47 Opinione Luçiano Boçi

TË RROFTË EMRI...

21:11 Opinione Lutfi Dervishi

Orët e Tiranës

17:02 Opinione Belind Këlliçi

Bëhu si Roni të kesh sukses në Shqipëri!

Lifestyle

09:00 Lifestyle

Jeshilja e ullirit/ Si ta kombinoni ngjyrën elegante që po "pushton" vitin

Jeshilja e ullirit ka rikthohet fuqishëm dhe pranon të bë